KOMUNIKATË PËR MEDIA

Llogaritë e Emetimeve në Ajër (LLEA), 2020

26.12.2023

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon rezultatet e hulumtimit statistikor “Llogaritë e Emetimeve në Ajër (LLEA) 2020. Ky është publikimi i parë i këtij lloji i realizuar në ASK.

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte që të ofrojë të dhëna të qëndrueshme statistikore për llogaritë e emetimeve në ajër në Kosovë ndërtimin e një sistemi statistikor për LLEA.

Rreth 75,0% të emetimeve të CO_2 në 2020 u liruan nga sektori i furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar

Të dhënat nga ky publikim tregojnë se ndotësit (emetimet) më të mëdhenj të ajrit në Kosovë në vitin 2020 ishin: CO2 (8,409 Gg); CH4 (23,44 Gg); bio CO2 (3,338 Gg) dhe N2O (1,99 Gg).

Ndërkaq, emetimet më të larta të CO2 në ajër nga të gjitha llojet e industrisë ishin:

- Sektori D (furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar) me rreth 75,0% (shprehur në numra absolut ishin 6 294 Gg);
- Sektori C (produkte e tjera minerale jo metalike - C23) me 296 46 Gg;
- Sektori C (prodhimi i metaleve bazë dhe produkteve metalike të fabrikuara, përveç makinerive dhe pajisjeve - C24/C25) me nga 181 88 Gg.

Gjithsej emetimet e CO_2 sipas llojeve të industrisë (NACE Rev.2), (Gg)



Gjithsej emetimet e CO_2 sipas llojeve të industrisë (NACE Rev.2), (%)



Rezultatet e paraqitura në këtë publikim ofrojnë një burim të rëndësishëm statistikor për gjendjen aktuale të Llogarive të Emetimeve në Ajër (LLEA) nga sektorë të ndryshëm të industrisë në Kosovë. Metodologjia e përdorur për realizimin e publikimit është në përputhje me Rregulloren e BE-së (BE) Nr. 691/2011 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 6 korrik 2011, mbi Llogaritë Ekonomike Mjedisore Evropiane.

Për më shumë informata lidhur me Llogaritë e Emetimeve në Ajër (LLEA) për vitin 2020, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/Environment